



**TEL: +38649510007 dhe +37744364106**

**e mail: [kosovajudo@hotmail.com](mailto:kosovajudo@hotmail.com)**

## **RAPORT**

### **Seminari per Refere dhe Trajner**

**Peje, Kosove**

**25 Shkurt 2018**

Ne palestren e e xhudos “Ippon” ne Peje u mbajt Seminari per Refere dhe Trajner.

Ky Seminar u mbajt pas perfundimit te Kampionitit te Kosoves ne menyre qe te pranishem te jene te gjithe perfaqesuesit e klubeve, trajneret dhe referet.

Seminari u udhehoq nga Fatos Tabaku ne rolin e trajnerit dhe Fatmir Salihaj ne rolin e Referit te cilet kete vit ishin pjesemarres ne Seminarin e pervjetshem per Refere dhe Trajner te organizuar nga Federata Boterore e xhudos, seminar dy ditor qe u mbajt ne Mittersil te Austrise.

Gjate ketij Seminari pati diskutime te shumta teorike dhe praktike per rregullat e reja te xhudos te cilat kane filluar te zbatohen qe nga 1 Janari I ketij viti dhe nuk do te ndryshohen deri ne perfundimin e Lojerave Olimpike ne Tokyo 2020.

Te dy udheheqesit e seminarit treguan qe keto rregulla sipas njoftimit te Federates Nderkombetare te xhudos u ndryshuan me qellim te zhvillimit te sportit te

xhudos,krijimit te nje imazhi pozitiv dhe qe ky sport te jete me I kuptueshem dhe me atraktiv per familje,spektatore,sponzore dhe media.

Fillimisht u qartesian pyetjet e shumta dhe te shpeshta qe kishin pjesemarresit.

Ne menyre praktike u demonstuan rregullat e reja ne xhudo.

Nder pikat kryesore qe u diskutuan ishin keto:

Dallimi ndermjet Ipponit dhe Wazarit

Renja ne ure dhe mbrojtja me koke

Diskualifikim (Hansoku-make) I dyfishte per xhudo negative

Referi ne qender te tatamive te kete me shume autoritet ne punen e tij dhe komisoni te nderhyje vetem kur ka ndonje gabim te madh

Vazhdimi I kontributit per xhudo pozitive

Poentimi dhe vleresimi I pikeve

Nder te tjera u diskutuan edhe pozicione te ndryshme valide dhe te ndaluara ne-waza.

Ky seminar ishte shume produktiv dhe te pranishmit u ndane te kenaqur me menyren e demostrimit te rregullave te reja.

FEDERATA E XHUDO S SE KOSOVES

PEJE,25 SHKURT 2018